

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-275/13

Prishtinë, 13 Maj 2015

Në çështjen juridike të:

B. H.

Në emër të Këshillit të Komunitetit Islamik në Pejë

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

I përfaqësuar nga avokati J. Ç.

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi, dhe Willem Brouwer, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00410), të datës 18 prill 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 13 Maj 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga Këshilli i Komunitetit Islamik në Pejë, kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/275/2013 të datës 18 prill 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA00410.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/275/2013 i datës 18 prill 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA00410.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 16 shkurt 2007, B. H. si person i autorizuar, në emër të Këshillit të Komunitetit Islamik në Pejë (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), e cila ishte regjistruar me numrin e lëndës KPA00410, ku ai kërkonte ri-posedimin e ngastrës kadastrale 462/2 (prona e kërkuar), në Rr.Ramiz Sadiku, zona kadastrale Pejë (zona nr.71611071), në Komunën e Pejës, e cila është e regjistruar si pronë shoqërore.
2. Së bashku me kërkesën, ai ka dorëzuar fletën poseduese të pjeshme nr. 2608 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Pejës më 28 prill 2004, ku ceket se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të P.SH. KK. i Pejës. Ai gjithashtu ka dorëzuar kopjen e planit kadastral, autorizimin, deklaratën e dërguar në Agjencinë Kosovare të Pronës dhe vërtetimin numër 01-3/574 të lëshuar më 13 dhjetor 2004 nga Kuvendi Komunal, Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë. Dokumentet e dorëzuara nga paraqitësi i kërkesës janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
3. Më 28 dhjetor 2010, AKP ka bërë notifikimin e pronës së kërkuar përmes publikimit të saj në Gazetën Zyrtare no.10. Gazeta dhe Lista ishin lënë në Komunë, Zyrën Kadastrale, Gjykatën Komunale dhe Zyrën Regjionale të AKP-së në Pejë, si dhe në OSBE, UNHCR, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ombudsperson te cilat kane pranuar t'i vënë ato në dispozicion të palëve të interesuara si dhe në hyrje dhe në dalje të fshatit Pejë.

4. Më 18 prill 2013, KKPK në vendimin e saj KPCC/D/A/196/2013 ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të faktit se kërkesa bie jashtë mandatit të Komisionit pasi që posedimi i pronës së kërkuar nuk ishte humbur si rezultat i konfliktit të armatosur.
5. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 21 tetor 2013. Më 20 nëntor 2013, është paraqitur një ankesë nga avokati J. Ç. që e përfaqësonte paraqitësin e kërkesës (në tekstin e mëtejme: palën ankuese).

Pretendimet e palës ankuese

6. Në deklaratën e dorëzuar në AKP me kërkesën, ceket se në vitet 1955-56, Kuvendi Komunal i Pejës e kishte ndarë ngastrën aktuale në pjesë më të vogla si 462/1 dhe 462/2 dhe e kishte regjistruar pjesën më të madhe të 0.0007.25 ha si pronë shoqërore. Përkundër kërkesës së Këshillit të Komunitetit Islamik për kthim të pronës së kërkuar nga Komuna e Pejës, kjo e fundit nuk ka treguar ndonjë vullnet apo gatishmëri për këtë punë. Paraqitësi i kërkesës kërkon kthimin e posedimit të pronës së kërkuar, të regjistruar në fletën poseduese nr. 2608, te pronari i saj i cili e ka humbur atë në vitin 1956.
7. Në ankesën e tij, pala ankuese thekson se vendimi i KPPK-së përfshin gabim thelbësor ose zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe procedurale. Për më tepër, argumentohet se vendimi nuk përmban asnjë arsyetim për refuzimin e kërkesës. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme të anulohet vendimin e KPPK-së, të njeh pronësinë e paraqitësit të kërkesës ose të ofrojë kompensim material për pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

8. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditësh siç parashihet me Ligjin nr. 03/L-079, neni 12.1 dhe është e pranueshme. Kolegji i Apelit të AKP-së ka juridiksion të shqyrtoj ankesën.

Meritat e ankesës

9. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK ka kompetencë të zgjidh kërkesat që kanë të bëjnë me konfliktin që përfshijnë rrethanat që drejtpërdrejtë ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Kështu, paraqitësi i kërkesës jo vetëm që duhet të vërtetohet te drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme private por edhe të vërtetohet se ai apo ajo nuk është në gjendje tani të ushtroj të drejtat e tilla për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë ndërlidhen me konfliktin e armatosur apo rezultojnë nga ai.
10. Nga provat e dorëzuara në KKPK, në veçanti deklarata e palës ankuese e dorëzuar së bashku me kërkesën, prona e kërkuar është regjistruar si tokë shoqërore në vitin 1956 që gjithashtu vërtetohet me Fletën Poseduese nr.2608 lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Pejës më 28 prill 2004. Pala ankuese gjithashtu e pranon se posedimi i tokës është humbur në vitin 1956 dhe që nga atëherë ajo është mundura ta marr atë sërish në posedim
11. KKPK ka mandat të kufizuar dhe merret vetëm me kërkesat pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private posedimi i të cilave është humbur për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Është e pakontestueshme se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar ka ndodhur në vitin 1956, shumë kohe para konfliktit të armatosur.
12. Gjithashtu, prona e kërkuar në kadastër është e regjistruar si prone shoqërore në emër të Komunës së Pejës. Prandaj, nuk ka mundur të konsiderohet se pala ankuese e ka dëshmuar të drejtën e pretenduar të pronësisë mbi pronën pak para konfliktit.
13. Rrjedhimisht, KKPK me të drejtë e ka konsideruar se ajo çështje ishte jashtë juridiksionit të saj. Arsyeja për hedhjen poshtë të kërkesës ceket në paragrafin 18 të vendimit ndërsa vendimi i vërtetuar për lëndën nr. KPA00410 i referohet paragrafëve 12 dhe 18 të vendimit në fjalë i cili ka të bëjë me më shumë se një kërkesë dhe i cili duhet të lexohet në lidhje me vendimin e vërtetuar individual. Prandaj, pretendimi i palës ankuese se KKPK nuk ka dhënë asnjë arsye për refuzimin e kërkesës nuk qëndron.
14. Gjykata Supreme thekson se, bazuar në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03-L/79, KKPK-së i mungon juridiksioni për të gjykuar kërkesën pasi që humbja e posedimit nuk rezulton nga rrethanat e konfliktit të armatosur. Sa i përket kërkesës së palës ankuese për kompensim, në bazë të Ligjit Nr. 03 / L-079 as Komisioni e

as Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme nuk ka juridiksion mbi një kërkesë të tillë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur as shkelje të së drejtës materiale apo të drejtës procedurale dhe as vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.

15. Bazuar në atë që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e paraqitësit të kërkesës për të kërkuar të drejtën e tij te pretenduar pranë gjykatës kompetente nëse e konsideron te nevojshme.

Këshillë juridike

16. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo mjeteve të jashtëzakonshme.

Sylejman Nuredini, Kryetare e Kolegjit

Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it